



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Primjeno/Prodato Received/Delivery	13.04.2022	viti god year	
Organ./Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
2080	2022	1/6	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.202/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi - Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.138/2022 të datës 03.03.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë:

kundër organit të punësimit/Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "Masë Disiplinore" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.202/2022 e datës 03.03.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. MBETET në fuqi Vendimi me numër KD.nr.001/2022 i datës 09.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ndaj ankueses, sipas shkresave të lëndës e punësuar në Shërbimi Korrektues të Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës me datë 12.01.2022 ka iniciuar procedurën disiplinore ndaj ankueses me pretendimet se e njëjta ka kryer shkelje disiplinore mbi bazën e të gjeturave në raportin e Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë të datës 06.01.2022.

Komisioni Disiplinor me datë 09.02.2022 ka nxjerrë vendimin me numër KD.nr.001/2022 njëherit ankuesen e ka gjetur përgjegjëse për shkelje disiplinore dhe i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalimi i 20% pagës për periudhën dy muaj".

Ankuesja kundër vendimit me numër KD.nr.001/2022 i datë 09.02.2022 të Komisioni Disiplinor, me datë 03.03.2022 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me Nr. Prot: 1137/2022 me pretendimin ankimor se Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ka vepruar në mënyrë jo të drejtë dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi që zyrtarja korrektuese që ishte nën menaxhimin tim është liruar nga përgjegjësia ndërsa mua në cilësi të menaxheres së saj më kanë gjetur përgjegjëse.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.03.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 07.03.2022 ka pranua nga Shërbimi Korrektues të Kosovës përgjigjen në kërkesë me numër protokoli:1204/2022, se bashku me shkresat e bashkangjitura. Po ashtu Shërbimi Korrektues me datë 16.03.2022 ka dërguar provat shtesë të ankesës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.prot:1137/2022 të datës 03.03.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shkresën e datës 05.08.2020 Përshkrimi i vendit të punës; Mbikëqyrës i Sigurimit; Vendimin e Komisionit Disiplinor i datës 09.02.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 08.03.2022; Përgjigjen në kërkesën e datës 16.03.2022 me e-mailin e bashkangjitur të datës 14.03.2022; ndryshimin dhe Plotësimin e Kontratës së punës të ankueses e datës 14.02.2020; Kontratën e punës së ankueses të datës 30.06.2018; Shkresën për inicimin e procedurës disiplinor të datës 12.01.2022; Raporti i Hetimit i Shërbimit Korrektues të Kosovës i datës 30.12.2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 07.03.2022; Vendimin e datës 20.10.2021 për themelimin e Komisionit Disiplinor; Ndryshimin dhe Plotësimin e kontratës së ankuesit të datës 11.02.2020; Kontratën e punës së ankuesit të datës 09.07.2013; fletë kthesën e datës 10.02.2022; Përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit e datës 03.01.2020; Regjistrimet ditore të gjendjes dhe sjelljeve të burgosurit të datës 30.12.2021; E-mailin e datës 03.09.2021 dërguar nga dërguar Njoftimin e datës 06.09.2021 dërguar nga menaxheri i rastit dërguar për Regjistrimet ditore të gjendjes dhe sjelljeve të burgosurit e datës 29.12.2021; Regjistrimet ditore të gjendjes dhe sjelljeve të burgosurit e datës 28.12.2021; Raporti i Mbledhjes Shëndetësore i rastit i datës 30.12.2021 përgatitur nga Dr. Udheheqëse e NJSHB/QKFL; Deklaratën e datës 30.12.2021 nga Kryeinfermierja Deklaratën e datës 30.12.2021 nga Raporti Mjekësor i datës 30.12.2021; Raportin e Ngjarjes i datës 30.12.2021 nga Plani Eventual-Vdekja në burg-Procedura e veprimit të oficerit në dhomën e kontrollit i datës 30.12.2021; Deklaratën 38 të Deklaratën 39 e Shkresën e datës 30.12.2021 me numër rendor:304 me shkresën e bashkangjitur të datës 31.12.2021 prej tre (3) faqesh; Procesverbalin e intervistës me stafin i datës 05.01.2022 me katër (4) shkresat e bashkangjitura të datës 31.12.2021; Shkresën e procesverbalit të datës 05.01.2022 i orës 10:30; Shkresën e procesverbalit të datës 05.01.2022 i orës 09:50; Shkresën e procesverbalit të datës 05.01.2022 i orës 14:55; Shkresën e procesverbalit të datës 05.01.2022 i orës 14:00; Shkresën e procesverbalit të datës 05.01.2022 i orës 11:00; Shkresën e procesverbalit të datës 06.01.2022 i orës 10:35; Shkresën e procesverbalit të datës 06.01.2022 i orës 11:25; Shkresën e procesverbalit të datës 06.01.2022 i orës 12:15; Kartoni i evidencës së vizitorëve sipas listës së planifikuar Formë 3.3.2/1; Kërkesa për kontrollë ose hospitalizim e datës 15.09.2020 për Kërkesa për kontrollë ose hospitalizim e datës 15.02.2021 për Fletë lëshimi i datës 25.03.2021 me numër amzës:34/29; Raporti i Departamentit Shëndetësor të Burgeve i datës 28.04.2021 në përbërje prej njëzetedy (22) faqesh; Aktvendimin me numër P.nr.328/21e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm i datës 27.04.2021; Aktgjykimin me numër P.nr.328/21 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm i datës 25.05.2021; Aktgjykimin me numër PAI.nr.798/2021 i Gjykatës së Apelit të Kosovës i datës 19.08.2021; Vendimi për formimin e komisionit të brendshëm hetimor i datës 31.12.2021; Aktvendimin e Panelit për lirim me kusht me numër PLK.D.nr.563/21; Raportet përmbledhëse për lirim me kusht i datës 17.09.2021; Kualifikimi për shqyrtim për lirimin me kusht

për të dënuarën i datës 20.09.2021; Raportin përmbledhës nga Ekipa profesioniste e institucionit korrektues për lirimin me kusht i datës 27.09.2021; Raportin shëndetësor për të burgosurën 23.09.2021; Deklaratën e datës 24.09.2021; Raporti Social për falje i datës 27.09.2021; Deklarim-premtim lidhur me mbikëqyrjen pas lirimit me kusht; Raporti përmbledhës për gjykatë për lirim me kusht të parakohshëm i datës 23.12.2021; Kërkesa për lirim të parakohshëm i datës 23.12.2021; E-mailin e datës 24.12.2021 dërguar nga për Raporti i vlerësimit për regjime i datës 04.10.2021; vendimin e datës 07.05.2021 i Drejtorit të QKFL; Raportin Inicives disiplinor; Njoftimi i të burgosurit për akuzën dhe kohën e seancës dëgjimore i datës 06.05.2021; Shënimin Zyrtar i datës 06.02.2021; Vendimin e datës 06.10.2021; Raporti inicives i datës 05.10.2021; Procesverbalet e seancave të komisionit për datat respektive 24 dhe 25.01.2022 për ankuesin dhe të tjerët; Raport inicives ër i datës 02.09.2021; Raport inicives ër i datës 06.04.2021; Shkresën zyrtare të datës 06.04.2021; Deklaratën e Raport për dëmtime trupore eventuale i datës 06.04.2021; Plani eventual-vdekje ne burg i datës 30.12.2021; Raportin e vizitave i datës 30.12.2021; Raportin mi gjendjen shëndetësore të paraburgosurve i datës 03.09.2021; regjistrin mbi informatat e të burgosurës me numër: QP-LP:000029/21; Procesverbali i intervistës me të datës 22.01.2022; Deklaratën e datës 30.12.2021; Ftesën për intervistë të datës 21.01.2022 për Ftesën për intervistë të datës 21.01.2022 për Ftesën për intervistë të datës 21.01.2022 për Ftesën për intervistë të datës 21.01.2022 për Ftesën për intervistë të datës 21.01.2022 për Ftesën për intervistë të datës 21.01.2022 për Ftesën për intervistë të datës 21.01.2022 për Ftesën për intervistë të datës 21.01.2022 për Ftesën për intervistë të datës 21.01.2022 për Regjistrimet ditore të gjendjes dhe sjelljeve të burgosurit për datën 30.12.2021 nga ora 03:30 deri në ora deri në ora 12: (i pa identifikueshëm numri); Deklaratën e Udhëheqëses së pavijonit e datës 31.12.2021; Raporti i Ngjarjes i datës 30.12.2021 nga zyrtarja Raporti i vetëvrasjes së të burgosurve i datës 30.12.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa A.nr.202/2022 e datës 03.03.2022, e parashtruar nga ankuesja është e **pabazuar**, sepse:

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesja ka të themeluar marrëdhënien e punës pranë Shërbimit Korrektues të Kosovës sipas kontratës të datës 01.07.2018 në pozitën "Mbikëqyrëse" në Qendrën Korrektuese Lipjan. Ndërsa sipas Ndryshimit dhe plotësimit të kontratës nga data 14.02.2020 është transferuar në pozitën "Mbikëqyrëse" në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan (Qendra Korrektuese për Femra).

Me Ligjin Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020 përkatësisht me nenin 4 paragrafi 1 është përcaktuar se: "*Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë. të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë*", nga rrjedh se me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë themelimi, ndryshimi, përfundimi i marrëdhënies së punës si dhe çdo e drejtë dhe detyrim nga marrëdhënia e punës për zyrtarët e shërbimit korrektues i nënshtrohet dispozitave të legjislacionit për nëpunësit civil dhe ligjeslicaionit të veçantë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës me datë 12.01.2022 ka iniciuar procedurën disiplinore ndaj ankueses me pretendimet se e njëjta ka kryer shkelje disiplinore në bazë të gjeturave të raportit të Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë me numër Nr.01-03 i datës 06.01.2022 ndërlidhur me rastin e vet varjes nga ana e një të burgosure, ndërsa Komisioni Disiplinor me datë 09.02.2022 ka nxjerrë vendimin me numër K.D.nr.001/2022 njëherit ankuesen e ka gjetur përgjegjëse për shkelje disiplinore dhe i ka shqiptuar masën disiplinore "*Ndalimi i 20% pagës për periudhën dy muaj*", ndërlidhur me rastin e vetë varjes të burgosurës me datë 30.12.2021 në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan (Qendra Korrektuese për Femra).

Po ashtu Kolegji, me rastin e shqyrtimit të kësaj lënde ka marr parasysh specifikat e institucionit sikurse edhe çështjen e legjislacionit të veçantë i përcaktuar si në nenin 4 paragrafin 2 nën paragrafët 2.1, 2.2, 2.3, 2.4 dhe 2.5 ku përcaktohet se: *“Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve”*.

Në bazë të shkresës së përgjigjes në kërkesë të datës 07.03.2022 të ofruar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës, është bashkangjitur edhe shkresa me Përshkrimin e Detyrave të Punës për pozitën të cilën e ushtron ankuesja *“Mbikëqyrës”* shkresë kjo e nënshkruar nga Menaxheri i Personelit, Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë si dhe Udhëheqësi më i lartë administrativ i Institucionit me datë 03.01.2020 ku ndër të tjera ka përcaktuar se detyrat kryesore për pozitën Mbikëqyrës janë: *“Mbikëqyrësi është përgjegjëses për mbikëqyrjen e zyrtarëve korrektues, kujdesin, ruajtjen dhe kontrollin dhe ri-integrimin shoqëror të burgosurve; Mbikëqyrësi është përgjegjës për implementimin e të gjitha rutinave ditore në burg për të burgosurit dhe personelin korrektues; ...Të ndihmojë në mbajtjen e sigurisë së burgut dhe efektshmërisë duke siguruar që oficerët korrektues i përcjellin procedurat dhe duke u siguruar që të gjitha lëvizjet e të burgosurve janë të monitoruara.....”*, ndërsa i raporton Mbikëqyrësit të Lartë.

Po ashtu, duke u bazuar në procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor të datës 24.01.2022 Kolegji ka gjetur se ankuesja kishte deklaruar se, citoj: *“... prej paneli kam shku në drekë jam khhy në pavijon për afërsisht në 11:45, kam pyet për risit zyrtaren Miradije dhe zyrtaren e caktuar në bravo, ju kam thënë zyrtareve mundeni me shkuar në drekë, ka bo mbylljen e kam pye si ishte, tha shtrirë pas njoftimit të D.H.R kemi(shkrim i palexueshëm)..ndërkohë kam shku në bravo, kam ndëgju zhurma për afërsisht sipas një ore që e kemi në viski ka qenë 12:27, kam shku në vendin e ngjarjes.”*, po ashtu në pyetjen e parashtruar nga anëtari i Komisionit Disiplinor se *“A je siguru se vëzhgimi i të dënuarve është bërë në rregull”*, ankuesja është deklaruar se: *“Vëzhgimi është bërë në rregull jam përgjegjëse për atë punë, edhe zyrtarët janë të vetëdijshëm”*, sikurse konfirmohet fakti në bazë të procesverbalit të datës 24.01.2022 se e njëjta ka qenë në dijeni se e dënuara ishte në mbyllje, ndërsa sipas raportit të datës 14.05.2021 të Komisionit Multidisciplinar për menaxhimin e rasteve me rrezik vetëvrasje të rasteve: ka qenë rekomandimi se e dënuara duhet të observohet çdo 30 minuta, kurse Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuses në arsyetim ka potencuar që ankuesja është përgjegjëse për shkelje të rënda disiplinore pasi që kanë konstatuar se në bazë të incizimeve të kamerave e ndjera nuk është vëzhguar nga ora 11:39 deri në momentin kur e dënuara e gjendet e vetë varur.

Po ashtu, ankuesja në ankesën e saj të datës 03.03.2022 të parashtruar në Këshill, nuk ka ofruar asnjë dëshmi apo provë relevante përveç deklaramëve dhe pretendimeve të saj ankimore dhe po ashtu as nuk e ka mohuar apo pohuar të gjeturën e Komisionit Disiplinor se në bazë të incizimeve të kamerave observimi ndaj të burgosurës nuk ishte kryer sipas obligimeve, pra çdo 30 minuta, përkundër faktit që ankuesja në procesverbal ka deklaruar se në ditën e njëjtë e burgosura e cila bëri vet varje ishte e shqetësuar, ndërsa në bazë të përshkrimit të detyrave të punës Mbikëqyrësi është përgjegjës: *“Të ndihmojë në mbajtjen e sigurisë së burgut dhe efektshmërisë duke siguruar që oficerët korrektues i përcjellin procedurat dhe duke u siguruar që të gjitha lëvizjet e të burgosurve janë të monitoruara”*, andaj mbi këtë bazë vendimi i komisionit disiplinor është i bazuar ngase ankuesja me rastin e mos përmbushjes së detyrave të punës respektivisht mungesës së observimit çdo 30 minuta para se të ndodhte rasti është përgjegjëse për shkeljen e kryer e përcaktuar si në nenin 46 paragrafi 1 dhe 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore; Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës”*.

Po ashtu. Kolegji me qellim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses se vendimi Komisionit Disiplinor nuk është i drejtë, ka analizuar edhe dispozitat e nenit 45 të Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”* si dhe nenit 50 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *“Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit. 2. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer. 3. **Për shkeljet e rënda, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafët 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji.** 4. Për shkeljet e lehta, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji. 5. Për çdo shkelje, jepet vetëm një masë disiplinore”* dhe ka konstatuar se Komisioni Disiplinor, ankuesit i ka shqiptuar masën më të lehtë disiplinore e cila mund t'i shqiptohet një nëpunësi civil me rastin shkeljes së rëndë të detyrave të punës e përcaktuar me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik siç përcaktohet se: *“1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil”* ndërlidhur me nenin 48 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor”*, nga rrjedh se Komisioni Disiplinor i ka marr për bazë parimet e individualizimit të masës, sjelljet e ankueses në të kaluarën dhe veprimet e tjera të mëhershme me qëllim kufizimit të dëmit, andaj bazuar në të gjeturat dhe konstatimet e pasqyruara si më lartë, pretendimet e ankueses se masa disiplinore e shqiptuar nga Komisioni Disiplinor është e padrejtë, janë të pabazuara në ligj dhe njëkohësisht të paqëndrueshme ndërsa masa e shqiptuar disiplinore mbetet në fuqi.

Kolegji po ashtu thekson faktin se Komisionit Disiplinor me rastin e nxjerrjes së vendimit të datës 09.02.2022 me numër KD.nr.001/2022 u ka shqiptuar masën e ndryshme disiplinore shtatë (7) zyrtarëve të cilët i ka gjetë përgjegjës për rastin e lart cekur, ndërsa refuzimi i ankesës së ankuesit të datës 03.03.2022 dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionit Disiplinor ka të bëjë vetëm me pikën VI të dispozitivit ku përcaktohet në mënyrë taksative masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankueses dhe e njëjta e pakënaqur me këtë masë ka iniciuar procedurën administrative me rastin e parashtrimin të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, andaj meqenëse ankesa ka qenë individuale, Kolegji konstaton se në këtë rast nuk mund të lëshohet përtej kompetencave dhe ka vendosur vetëm për rastin e ankueses


Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë– Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.202/2022

Flakron GASHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

